




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
OEVERIA - VLADA - GOVERNMENT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT - ODELJENJE ZA INSPEKCIJE - DEPARTMENT OF INSPECTION



Referencë: **IPK/21032022/DI**
Datë: **21.03.2022**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit dhe raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024) dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

| | |
|---|--|
| Titulli - objekti | - Administrimi i parave të imëta në Policinë e Kosovës |
| Referenca | - 01/2022 |
| Data e inicimit | - 15.02.2022 |
| Data e raportimit | - 21.03.2022 |
| Arsyet e inicimit | - Bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (2022) |
| Objektivi | - Respektimi i procedurave dhe rregullave të shpenzimit të parave të imëta (petty cash) |
| Metodologjia | - Intervistë (takime) me dy (2) drejtues dhe bartës funksionesh: (a) Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, (b) Zyrtari Financiar për Para të Gatshme. - Këqyrje dhe verifikim: 14 dosje të administrimit të parave të imëta; - Marrje dokumentesh për nevoja të raportimit. |
| Subjekti | - Drejtoria për Buxhet dhe Financa Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse |
| Afatet | - Fillimi - 23.02.2022; - Përfundimi - 24.02.2022; - Periudha e mbulimit - viti 2021. |
| Kriteret vlerësuese (standardet) | - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; - Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike; - Rregullore MF-Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin - Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës; - Procedura e avancave për paranë e imët dhe udhëtimeve zyrtare në SIMFK; - Procedura Standarde e Operimit - Paratë e gatshme; - Formularët e emërimit të zyrtarëve autorizues dhe aprovues të parave të imëta. |

| | |
|------------------------|--|
| Ekipi realizues | - Servet Tasholli, udhëheqës i ekipit të inspektimit, - Kadri Keçmezi, inspektor, - Shqiponjë Sopi, inspektor, - Teuta Rukolli - Ajeti, inspektor |
| Mbikëqyrur nga | - Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit |
| Mbështetur nga | - Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi |
| Dorëzuar nga | - Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit |
| Miratuar nga | - Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së |
| Datë | - 21.03.2022 |



| | |
|---------------------------------|---|
| <p>Gjetjet kryesore:</p> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Paratë e imëta janë fond i parave që mbahen nën përkujdesjen-kontrollin e organizatës buxhetore dhe që shfrytëzohen për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël. Lidhur me caktimin e shumës së avancave për para të gatshme, Procedura e avancave për paranë e imët dhe udhëtimet zyrtare në SIMFK rregullon që organizata buxhetore në fillim të vitit i parashton kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit për caktimin e shumës së parasë së imët, i cili më pas vendosë për caktimin e shumës që do t'i jepet në dispozicion organizatës buxhetore. Ministria e Financave ka aprovuar një kërkesë të tillë dhe ka lejuar limitin financiar prej 2.500 € për drejtoritë rajonale dhe 5.000 € për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë (DPP) dhe departamentet vartëse. 2. Sipas dispozitave të legjislacionit mbi Menaxhimin Financiar e Kontrollin (MFK), organizata buxhetore do të caktojë Zyrtarin e mbajtjes së parave të imëta. Rregulla financiare nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike në nenin 29 përcakton që ky zyrtar është përgjegjës për sigurinë e fondit, për procedimin e pagesave, për barazimin me Thesarin dhe rimbushje të fondit. Policia e Kosovës ka caktuar Zyrtarin e parave të imëta dhe nga kontrolli i kryer vërehet se i njëjti është përkujdesur që dosjet të kenë një materie të pasur për të argumentuar e proceduar pagesat nga fondit. Kurse, nëpër drejtori rajonale janë caktuar tetë mbajtës të parave të imëta. Zyrtari i parave të imëta procedon e mirëmban fondet e parave të imëta për DPP-në, kurse në drejtori rajonale përkujdesen mbajtësit e parave të imëta. 3. MFK parasheh delegimin e përgjegjësive-detyrave të një numër zyrtarësh financiar. Delegimi përfshinë caktimin e autoritetit për të kryer funksione specifike, që realizohet nga menaxhmenti të menaxherët e njësisë. Lidhur me shpenzimin e fondit për para të imëta ndahen përgjegjësitë-detyrat për zyrtarët autorizues dhe aprovues. Sipas Rregullores MF - nr.01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, delegimi i kompetencave bëhet në mënyrë zyrtare dhe mbahen shënime për autorizimet. Nga ky inspektim rezulton se delegimi i përgjegjësive për zyrtarët autorizues dhe aprovues ka ndodhur paraprakisht dhe kjo konfirmohet nga formularët përkatës, ku pranimi i kompetencave është bërë me nënshkrimin e palëve. Meqenëse, Policia është organizatë e madhe, dinamike, me numër të madh kërkesash për para të imëta, ka nevojë që të shfrytëzojë edhe avanca për para të imëta në nivel qendror dhe rajonal. Lidhur me këtë, kompetencat për autorizimin dhe aprovimin e shpenzimeve janë deleguar të një numër zyrtarësh në këto nivele. Po ashtu, edhe mbajtësit e parave të imëta në drejtori rajonale kanë nënshkruar deklaratat për mbajtjen e parave të imëta. 4. IPK-ja ka verifikuar procesin e tërheqjes - kthimit të mjeteve nga Thesari dhe anasjelltas, po ashtu edhe aktivitetet e pranimit - dorëzimit të parave të imëta ndërmjet Zyrtarit të parave të imëta dhe Mbajtësve të parave të imëta nëpër drejtori rajonale, aktivitete këto që janë dëshmuar me shkresa. Mbajtësit e parave të imëta shpenzojnë mjetet në kuadër të limiteve financiare dhe në fund barazohen me Zyrtarin financiar të parave të imëta. Inspektimi i dosjeve të avancave të parave të imëta rezultoi që shpenzimet në kuadër të drejtorive rajonale në gjitha rastet përmbledhen në formularët standard të njohur si Specifikimi i parave të imëta, të cilët periodikisht i paraqiten Zyrtarit të parave të imëta në Sektorin e Buxhetit dhe Financave të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. |
|---------------------------------|---|

| | |
|--|---|
| | <p>5. Nga kontrolli i të gjitha dosjeve të avancave për para të gatshme për vitin 2021, del se Policia e Kosovës ka shpenzuar 39.311,84 €, nga të cilat:</p> <p>(a) DPP dhe departamentet.....23.161,23€ (59%), (b) Drejtoritë rajonale.....16.150,61 € (41%).</p> <p>Sa i përket strukturës së shpenzimeve sipas kategorive në nivel të Policisë së Kosovës, kemi këtë pasqyrë shpenzimesh:</p> <p>(a) Furnizim me ushqim e pije (13620).....23.182,93 € (59%), (b) Pajisje tjera (13509).....4.775,64 € (12%), (c) Riparimi i automjeteve (14010).....3.950,95 € (10%), (d) Mirëmbajtja e ndërtesave e pajisjeve (14020).....1.724,09 € (4%), (e) Të tjera.....5.678,23 € (15%).</p> <p>Sa i përket strukturës së shpenzimeve sipas kategorive në nivel të DPP-së, kemi këtë pasqyrë shpenzimesh:</p> <p>(a) Furnizim me ushqim e pije (13620).....9.119,80 € (39%), (b) Pajisje tjera (13509).....3.387,61 € (15%), (c) Riparimi i automjeteve (14010).....3.950,95 € (17%), (d) Mirëmbajtja e ndërtesave e pajisjeve (14020).....1.724,09 € (7%), (e) Të tjera.....4.978,78 € (22%).</p> <p>Sa i përket strukturës së shpenzimeve sipas kategorive në nivel të tetë (8) drejtorive rajonale, kemi këtë pasqyrë shpenzimesh:</p> <p>(a) Furnizim me ushqim e pije (13620).....14.063,14 € (87.1%), (b) Pajisje tjera (13509).....1.388,03 € (8.6%), (c) Të tjera.....699,45 € (4.3%).</p> <p>Nga analiza e shpenzimeve të përgjithshme vërehet se rreth 59% e parave të imëta është shpenzuar për "Furnizim me ushqim dhe pije". Kjo kategori te drejtoritë rajonale përfaqësohet me 87% (në kuadër të shpenzimeve të DPP-së kjo kategori përfaqësohet me 39%). Sipas zyrtarëve përgjegjës të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtoritë rajonale nuk kanë shërbime të bufesë dhe detyrohen që reprezentacionin e lejuar ta shpenzojnë nga paratë e imëta. Në nivel të DPP-së, këto shpenzime janë më të ulëta në përqindje sepse disa struktura policore të vendosura në objekte qendrore shfrytëzojnë reprezentacionin duke shfrytëzuar shërbimet e kontraktuara. Pagesa nga fondi i parave të imëta të DPP-së janë kryer për mbulimin e reprezentacionit dhe të drejtorive rajonale të policisë kufitare, që operojnë në objekte jashtë qytetit të Prishtinës. IPK-ja ka hasur se Policia ka nxjerr një Procedurë Standarde të Operimit (11.02.2015), me të cilën i ka hapur rrugë shpenzimit të parave të imëta edhe për reprezentacionin. Lidhur me këtë, IPK-ja vlerëson se PSO ka nxjerrë rregull, të cilën nuk e ka hasur në legjislacionin në fuqi mbi financat publike.</p> <p>6. IPK është interesuar të njihet me procesin e shfrytëzimit të parave të imëta duke filluar nga ngritja e kërkesës për para të imëta, deri te realizimi i tyre. Me këtë rast, ka inspektuar dosjet e 9 avancave dhe 5 rimbushjeve që kanë rezultuar me 1.241 transaksione (pagesa). Transaksionet kanë kërkesat e bashkëngjitura nga ngritësit e tyre, të cilat janë autorizuar dhe aprovuar nga personat përgjegjës, si dhe në secilën prej tyre janë të bashkëngjitura faturat. PSO që ka nxjerrë Policia mbi paratë e gatshme ka standardizuar një formular përmes të cilit përcillet rrjedha e shpenzimit të parasë së imët. Sa i përket formave standarde të Thesarit nuk është hasur të jetë përdorur formulari nr. TH-SHQ-FPP-05 - Fletëpranimit Standard i Parasë së Imët.</p> |
|--|---|

| | |
|--|--|
| | <p>Vërehen praktika të mira nga ngritësit e kërkesave në verifikim të stoqeve të mundshme dhe kontratave me operatorët ekonomik. Policia e Kosovës ka konsoliduar zinxhirin e komunikimit nga ngritja e kërkesës për para të imëta deri tek realizimi i kërkesave.</p> <p>7. Paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullës Financiare nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike përcakton se fondet e parave të imëta do të shfrytëzohen për të paguar blerjet e ndryshme me vlera të vogla, që paraqiten në raste të paparashikueshme. Gjithashtu kjo Rregull në paragrafin 6.1 të këtij neni tërheq vërejtjen se paratë e imëta nuk mund të shfrytëzohen për shpenzime që mund të bëhen praktikisht përmes procesit të rregullt të shpenzimeve. Inspektimi i transaksioneve vë në pah se faturat e reprezentacioneve nuk mund të konsiderohen shpenzime të paparashikueshme dhe se për to mund të arrihen kontrata me operatorë ekonomik ose mund të shfrytëzohen edhe kontratat ekzistuese. Shuma të konsideruar nga paratë e imëta janë paguar për mbulimin e shpenzimeve të reprezentacionit për drejtoritë rajonale dhe ato kufitare. Kjo është rezultat i mos seriozitetit e neglizhencës në arritjen e kontratave me operatorët ekonomik, për të realizuar furnizimet e kësaj natyre. Operatorët ekonomik do të mund të furnizonin drejtoritë në baza periodike me artikuj reprezentacioni. Në këtë mënyrë, fondet e parave të imëta do të mund të ruheshin dhe do të mund të jenë të disponueshme për blerje dhe situata të paparashikueshme.</p> <p>8. Rregulla financiare në nenin 29, paragrafi 7, përcakton se organizata nuk mund të pranojë fatura të shumëfishta nga një furnitor, për të zvogëluar shumën e faturave individuale në më pak se 100 €, me qëllim të realizimit të një pagese. Nga kontrolli i transaksioneve është hasur në disa raste kur është lëshuar më tepër se një faturë brenda ditës nga operatori i njëjtë, që kalojnë vlerën totale prej 100 €, por të faturuara në vlera më të ulëta. Tek avancat që lidhen me pesë Urdhër Obligim Pagesa (30510960, 30512932, 30512277, 30510079 dhe 30511627) janë hasur gjithsej 120 transaksione ku operatorët ekonomik kanë lëshuar nga një (1) deri në pesë (5) fatura brenda një dite, fatura këto me vlera të vogla, që në mënyrë kumulative tejkalojnë vlerën mbi 100 €. Shumica e këtyre transaksioneve lidhen me operatorët ekonomik që kanë ofruar furnizime për reprezentacion.</p> <p>9. Nga inspektimi i shpenzimeve të realizuara dhe pagesat e bëra ka rezultuar se 21 blerje që lidhen me UOP-të e cekura më lartë janë realizuar para se të autorizohen dhe aprovohen kërkesat e njëjësive kërkuese. Mesatarisht tek këto raste ka pasur mospërputhje për rreth 5 ditë të datës së faturimit me datën e tërheqjes së parave të imëta nga Fondi. Nga formularët e pranimit-dorëzimit të parave të imëta vërehen se datat janë më të vonshme se datat e faturave. IPK-ja kupton urgjencën që mund të kenë strukturat policore për të siguruar artikujt që do të paguhen me para të imëta, por duhet kuptuar se mund të krijohen situata kur për artikujt e furnizuar, mos të ketë para të imëta në kuadër të fondit. Shumica e këtyre blerjeve shihet se janë kryer për nevoja të Drejtorisë së Menaxhimit të Objekteve dhe Flotës Operative. Në të ardhmen duhet ndjekur hapat e nevojshëm në shpenzimin e parave të imëta, në mënyrë që të mos krijohen shpenzime pa u siguruar se janë të disponueshme mjetet e nevojshme për mbulimin e tyre.</p> |
|--|--|

| | |
|--|--|
| <p>Vlerësimi i përgjithshëm</p> | <p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✦ Policia e Kosovës ka në dispozicion dhe shfrytëzon avanca për para të imëta në limitet e aprovuara nga Zyra e Thesarit, në lartësi prej 5.000 € për DPP-në dhe 2.500 € për drejtoritë rajonale; ✦ Policia e Kosovës ka të caktuar Zyrtarin e parave të imëta që procedon dhe mirëmban fondet e imëta, kurse nëpër drejtoritë rajonale ka edhe mbajtësit e parave; ✦ Policia e Kosovës ka deleguar përgjegjësitë dhe detyrat tek një numër zyrtarësh financiar, duke i caktuar si autoritete për të kryer funksione specifike nga fusha e administrimit të fondit të parave të imëta (zyrtarë autorizues, aprovues dhe mbajtësit e parave); ✦ Ka një ndarje të qartë të kompetencave ndërmjet Zyrtarit të parave të imëta dhe mbajtësve të parave në regjione; ✦ PSO për paratë e gatshme po përdoret nga struktura policore si mundësi për të mbuluar shpenzimet e reprezentacionit nga fondi i parave të imëta ✦ Procesi i shpenzimit të parave të imëta ka rrjedhë solide të procedimit të lëndëve dhe ekziston një zinxhir i konsoliduar i komunikimit lidhur me verifikimin e stokeve dhe kontratave me operatorët ekonomik; ✦ Me gjithë faktin se me para të imëta parashihet të mbulohen shpenzime të paparashikueshme, janë hasur edhe shpenzime të paguara, për të cilat në të ardhmen duhet shqyrtohet mundësia e kontraktimit të tyre; ✦ Janë hasur edhe raste kur nga fondi i parave të imëta janë paguar fatura të shumta të operatorëve ekonomik, vlera kumulative e të cilave brenda një dite tejkalon limitin e parashikuar prej 100 €; ✦ Janë hasur transaksione kur furnizimet janë realizuar para se kërkesat të autorizohen, aprovohen dhe të lejohen paratë e imëta. |
| <p>Rekomandimet</p> | <p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✦ IPK-ja i rekomandon Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, të sigurohet se PSO për paratë e gatshme lidhur me mbulimin e reprezentacionit nga fondet e parave të imëta, që të mos bie ndesh me legjislacionin në fuqi mbi financat publike; ✦ IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që të sigurohet se paratë e imëta shpenzohen për mbulimin e shpenzimeve të paparashikueshme, e assesi për ato që mund të kontraktohen përmes të procedurave të prokurimit; ✦ IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Buxhetit dhe Financave, dhe Zyrtarit të parave të imëta që të shtojnë kontrollin në drejtim të eliminimit të faturave të shumëfishta nga operatorë ekonomik të njëjtë, vetëm sa për të mos tejkaluar limitin prej 100 €; ✦ IPK-ja u rekomandon ngritësve të kërkesave për para të imëta, zyrtarit të parave të imëta dhe mbajtësve të parave të imëta, që të kujdesen që blerjet e artikujve të realizohen vetëm pasi të jenë autorizuar e aprovuar kërkesat e tyre, si dhe kur të jenë siguruar paratë e imëta nga Fondi. |

| Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit | | | | |
|--|--|----------------------|---|------------------|
| Nr. | Rekomandimi | Niveli i prioritetit | Komentet e strukturës policore (në original) | Plani i veprimit |
| 1. | IPK-ja i rekomandon Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, të sigurohet se PSO për paratë e gatshme lidhur me mbulimin e reprezentacionit nga fondet e parave të imëta, që të mos bie ndesh me legjislacionin në fuqi mbi financat publike. | -I- | Jemi në proces të ndryshimit dhe plotësimit të PSO-së në të cilën përcaktohen me hollësisht rregullat financiare dhe procedurat për shpenzimin e parave të gatshme. Kjo PSO do të udhëzojë mënyrën dhe hapat që duhen të ndërmerren për shfrytëzimin sa më të drejtë dhe racional të parave të gatshme si dhe të jete në përputhje të plote me ligjin dhe rregullat në fuqi. | |
| 2. | IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që të sigurohet se paratë e imëta shpenzohen për mbulimin e shpenzimeve të paparashikueshme, e assesi për ato që mund të kontrahohen përmes të procedurave të prokurimit. | -I- | Paratë e imëta shfrytëzohen vetëm për kërkesa urgjente dhe të paparashikueshme duke u siguruar se këto produkte nuk janë në stok, nuk ka kontrate valide për këtë dhe duke kërkuar arsye shtese pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen dhe si këto shpenzime kontribuojnë në përmbushjen misionit, qëllimeve dhe objektivave të organizatës. Zyrtari i parave të imëta në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet dhe Financa në mënyrë permanente kujdesen që të reduktohen numri i kërkesave të përsëritura dhe të zgjidhet problemi i artikujve me mundësi të lidhjes së kontratës. Shpenzimet e reprezentacionit është e vërtetë se zënë shumen me të madhe, mirëpo edhe pse janë iniciuar kërkesa dhe janë hapur disa here tender për hapje të byfeve neper të gjitha rajonet, nuk kemi pasur ofertues të përgjegjshëm dhe kemi tentuar që shpenzimet e reprezentacionit të bëhen në këtë mënyrë nëpërmjet byfeve. Nëse lidhim një kontrate për furnizim me pije të reprezentacionit, kosto do të ishte shume me e larte për furnizim për shkak të sasisë së vogël të furnizimit dhe transporti do të jete një kosto shtese, në raport me kostë benefitin do të krijohen kosto shtese të pa nevojshme dhe do të krijohet dëmtim i buxhetit, zgjedhje e vetme do të mbetet hapja e byfeve neper rajone dhe ndalimi i furnizimit të reprezentacionit përmes parave të gatshme, gjë të cilën do të insistojmë të zbatojmë. | |
| 3. | IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Buxhetit dhe Financave, dhe | -I- | Drejtoria për Buxhet dhe Financa në vazhdimësi kujdeset që të gjitha | |

| | | | | |
|----|--|-----|--|--|
| | <p>Zyrtarit të parave të imëta që të shtojnë kontrollin në drejtim të eliminimit të faturave të shumëfishta nga operatorë ekonomik të njëjtë, vetëm sa për të mos tejkaluar limitin prej 100 €.</p> | | <p>kërkesat e mjeteve të jenë të arsyetuara me faturë si dhe të jenë në përputhje me limitet e përcaktuara me rregullat përkatëse në fuqi. Vazhdimisht kujdesemi që të sigurojmë dëshmi të mjaftueshme rreth shërbimeve të ofruara sipas çmimit të tregut. Gjithashtu kujdesemi që mos të ketë ndarje të faturave të cilat përmbajnë shërbimin apo furnizimin e natyrës së njëjtë. Po ashtu do të punojmë në drejtim të reduktimit të faturave të shumëfishta nga operatorët e njëjtë.</p> | |
| 4. | <p>IPK-ja u rekomandon ngritësve të kërkesave për para të imëta, zyrtarit të parave të imëta dhe mbajtësve të parave të imëta, që të kujdesen që blerjet e artikujve të realizohen vetëm pasi të jenë autorizuar e aprovuar kërkesat e tyre, si dhe kur të jenë siguruar paratë e imëta nga Fondi.</p> | -I- | <p>Duke pasur parasysh natyrën urgjente të kërkesave të cilat realizohen nga ky fond në vazhdimësi kujdesemi që blerjet e artikujve të realizohen në përputhje të plote me procedurat të cilat duhet ndjekur. Rastet të tilla ndodhin vetëm duke vlerësuar situatën, rrethanat dhe pasojat e riskut të cilat mund të rezultojnë me humbje, dëme apo efekte të padëshirueshme si pasojë e mos realizimi të tyre. Këto shërbime ndikojnë në misionin, qëllimin dhe objektivat e institucionit si dhe reduktimin e dëmeve të cilat mund të rezultojnë si pasojë e afatit kohor. Kërkesat e tilla janë të lidhura me riparimin e veturave, prishje të pajisjeve elektrike me zëvendësimi apo riparimin e tyre si dhe riparimin e sistemit të hidrosanitarisë, dhomat e dëshmimeve, dhe ndërrime të cilindrave të cilët paraqesin rrezik nëse nuk veprohet me kohe. Do të bëjmë përpjekje që të ngritet niveli i komunikimit dhe të shmangim situatat e shpenzimit pa aprovim paraprak të Drejtorit për Buxhet dhe Financa.</p> | |